



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 02.02.2016 në orën 10:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Ilir Deda, Luljeta Veselaj-Gutaj, Arben Gashi, Kujtim Paqaku.

Munguan: Vjosa Osmani, Rustem Mustafa, Valdete Bajrami, Slobodan Petroviq dhe Time Kadrijaj.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.
Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raporti nga vizita zyrtare në Bruksel, dt. 26-29 janar 2016;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L060 për Mjekësinë Ligjore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja pyeti anëtarët se a pajtohen me këtë rend të ditës.

Ilir Deda kërkoi që pika e 4 të hiqet prej rendit të ditës, sepse tha se jemi marrë vesh në Bruksel, që të mbahet mbledhja vetëm për raportin nga vizita zyrtare në Bruksel dhe shqyrtimin e Planit të punës, i cili i merr parasysh udhëtimet tona që duhet bërë, deri më 15 mars, pra pa pikat tjera. Pas votimit, kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me heqjen e pikës së katërt.

2. Raporti nga vizita zyrtare në Bruksel, dt-26-29 janar 2016

Kryetarja tha se para vetit e kemi një draft fillestar dhe të papërfunduar, lidhur me vizitën në Bruksel. Ky raport nevojitet për të treguar vizitën që e kemi bërë dhe për vendimin që e morëm sa ishim në Bruksel, me kërkesë të znj. Lunaçek dhe të deputetëve tjerë, që lidhur me liberalizimin e vizave, në mënyrë të përsheptuar, t'i bëjmë disa vizita, jo vetëm në shtetet që nuk e njohin Kosovën, por ka shtete që e kanë njohur Kosovën, por kanë pengesa nga qytetarët e vet. Pra, duhet ta vizitojmë Gjermaninë, duhet të flasim me parlamentin dhe ministrat e Punëve të Brendshme të Francës, Suedisë dhe Holandës, shtete këto mike të Kosovës, por që janë duke u përballur me fluksin e madh të refugjatëve dhe me probleme të tyre të brendshme.

Gjithë kësaj, nuk po i ndihmojnë pengesat në Kuvendin e Kosovës dhe ata drejtpërdrejt na thanë se deputetët e Parlamentit Evropian janë politikanë dhe ata nesër përsëri do ta kërkojnë votën dhe po kanë presion prej qytetarëve të vet për liberalizim të vizave, duke parë situatën dhe skenat që po i shikojnë në televizion për ngjarjet në Kuvendin e Kosovës.

Andaj, detyrë e jona, ashtu si jemi marrë vesh në Bruksel, është që të ndahemi në grupe, dhe në mënyrë të përsheptuar, të shkojmë e të bisedojmë dhe të tregojmë se qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë këtë situatë, në të cilën gjendemi dhe nuk pritet të ndodhë ai fluksi i madh i refugjatëve, që ndodhi në janarin e vitit të kaluar. Po ashtu, një numër i madh i tyre janë duke u kthyer dhe janë ndërmarrë të gjitha masat që mos të përsëritet, sepse miqtë tanë janë duke punuar për të përsheptuar procesin e liberalizimit të vizave dhe të kenë, gjithashtu, votat prej ministrave të Punëve të Brendshme të këtyre shteteve dhe prej qytetarëve të tyre, andaj është dashur të futet në rend dite raporti i papërfunduar dhe për të marrë vendim në Komision, për të bërë vizita në shtetet e lartpërmendura.

Lidhur me këtë pikë, hapi debat

Luljeta Veselaj-Gutaj, lidhur me raportin e vizitës theksoi se, edhe pse është vetëm një draft, duhet të përfshihen të gjitha diskutimet, sepse ne kemi pasur takime dhe diskutime shumë të rëndësishme. Kishte vërejtje pse nuk është përfshirë diskutimi i saj me grupin punues të Ballkanit Perëndimor, që ka qenë diskutim shumë i rëndësishëm. Gjithashtu, edhe një prononcimin që e kishte pasur dhe takimi me komisionarin Hahn, nuk janë përfshirë, si dhe diskutimet e deputetëve tjerë në takimet tjera, të cilat kanë qenë diskutime të nivelit shumë të lartë dhe me ndikim shumë të fuqishëm.

Kujtim Paqaku, e konsideroi vizitën në Bruksel, si shumë të suksesshme, sepse të gjithë deputetët pjesëmarrës kanë dhënë një kontribut të pashoq, dhe për herë të parë, nuk është shikuar se cilët deputetë janë pozitivë dhe opozitivë, dhe në mënyrë perfekte, të gjithë njëzëri, jemi munduar të bëjmë një lobim. Gjatë takimeve, ata na treguan për gjërat negative dhe se ne jemi ata që duhet të punojmë për shtet. Shpresoj që e kemi arsyetuar vizitën. dhe të shpresojmë që edhe në vizita tjera dhe se kemi sinjale pozitive që mund të bëjmë lobim të mirë. Në fund, tha se kam dëshirë që deputetët e opozitës, ashtu si po e japin kontributin e tyre nëpër Bruksel dhe nëpër Evropë, të vijjnë edhe në Komision dhe të japin kontributin, sepse vetëm me punë serioze mund të shkojmë përpara.

Arben Gashi, tha se po i japim shumë nota tragjike asaj vizite. Është e vërtetë se është konstatuar që të gjitha takimet që i kemi pasur, për Kosovën nuk janë shumë optimiste dhe lehtësuese për punën që e bëjnë përkrahësit e Kosovës, në kuadër të institucioneve të vendit dhe na është rekomanduar që pamje të tilla mos të ketë në Republikën e Kosovës, duke pasur parasysh faktin se janë 5 vende jo njohëse, që së bashku me disa deputetë individualë, kanë rritur presionin në deputetët e Komisionit Evropian, të cilët më herët kanë qenë përkrahës të Kosovës, të shndërrohen në abstenues ose ata që kanë qenë abstenues, të shndërrohen në kundërshtues të rezolutave për Kosovën dhe vendimeve që nxirren në favor të Kosovës. Po ashtu, është e vërtetë se ne duhet të jemi më të angazhuar në raport me BE-në. Është pozitiv fakti se LDK-ja ka një instrument politik, mbi bazën e cilit komunikon dhe dërgon mesazhe në vazhdimësi, që është instrumenti politik i partive popullore evropiane. Po ashtu, është e vërtetë se brenda partive popullore evropiane, ka deputetë që janë anëtarë të partive popullore evropiane, që i kundërshtojnë rezolutat që janë në favor të Kosovës, sepse janë vende që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Situata është komplekse, sepse është rritur pakënaqësia, për shkak të zhvillimeve të fundit në Kuvend dhe për shkak të emigrimit që e kishim vitin e kaluar. Të gjitha këto elemente, janë jo-favorizuese për Kosovën dhe është rekomanduar që të ketë një bashkëpunim më të drejtpërdrejtë dhe të përdoren mekanizmat diplomatikë, diplomacisë parlamentare dhe politikës së partive, linjat e komunikimit që kanë partitë dhe të shihet mundësia e bashkëpunimit ose hyrja e komunikimit direkt me vendet kryesore strategjike: Gjermaninë, Francën, Holandën dhe Suedinë, sepse këto janë vende që janë afektuar drejtpërdrejt prej azilkërkuesve nga Kosova dhe këto kanë rritur shkallën e pakënaqësisë, kanë shkaktuar probleme dhe mund të shkaktojnë probleme në procesin e liberalizimit të vizave dhe proceseve tjera. Në fund, tha se edhe deputetët e opozitës, në raport me interesin strategjik të Kosovës, kanë qenë mjaft korrekt dhe konstruktiv në të gjitha takimet që i kemi pasur. Përshtypja që krijohet nga këto vizita, është se ka një shqetësim të shtuar, në kuadër të institucioneve evropiane, të cilët për ne janë partnerë strategjik për klimën politike që po ndodh në Kosovë dhe nuk është klimë ndihmuese për vendet mike të Kosovës dhe për askënd. Mendoj se kjo duhet të zgjidhet sa më shpejt.

Ilir Deda, tha se ideja është që të tregojmë se cilat janë mesazhet që i kemi dhënë dhe i kemi dëgjuar, si dhe praktika e transmetimit sipërfaqësor të mesazheve, nuk është korrekte. Ne të gjithë ishim në takime të njëjta dhe prononcimet që i pashë dje, nuk reflektojnë plotësisht atë çka kemi dëgjuar. Atë që ne duhet t'ju tregojmë qytetarëve, është që ekziston iniciativa e BE-së për të ardhur në Kosovë dhe për të ndërmjetësuar në krizën politike, kurse sa i përket liberalizimit të vizave, na është thënë qartë se nëse gjatë shkurtit nuk plotësohen 8 kriteret, plotësisht, nuk ka liberalizim. Nuk e di çka po themi tash se këtë vit do të ketë, këtë vit nuk do të ketë. Pse po i mashtrojmë qytetarët. Nëse në muajin shkurt Kuvendi nuk i kryen punët e veta, nuk ka marrëveshje politike dhe nuk ecë Kosova përpara, nuk ka liberalizim. Nëse Avokati i Popullit nuk është në ndërtesën e re, e Gjykata Kushtetuese nuk është në ndërtesë tjetër, fondi për integrim, çka po flasim ne për liberalizim.

Ne kemi kaluar kohë me ekipin e zonjës Mogherini, kemi biseduar për dialog dhe aty janë vërejtur disa shqetësime. Pra, shqetësimi kyç ka qenë, pse nuk është marrë parasysh vendimi i Gjykatës Kushtetuese në dialogun e dy kryeministrave, në komunikatën e zonjës Mogherini.

Ajo na ka thënë qartë se komunikatat e saj, pra ekipi i saj na tha se komunikatat e saj draftohen vetëm me aprovim të dy kryeministrave. Ata, për situatën e krijuar, ia kanë hedhur përgjegjësinë edhe qeverisë, edhe opozitës, kurse këtu jepen deklarata thuajse ata e kanë fajësuar vetëm njërën anë. Dhe nuk mund të besoj. Ne, pas gjithë atyre, kthehemi këtu dhe fillojmë të kthehemi në ushtarë partiakë. Kjo nuk është korrekte, sepse barra e përgjegjësisë, siç na kanë thënë, është e të gjithëve. Në fund, kërkoj që raporti nga vizita t'u shpërndahet të gjithëve, në mënyrë elektronike, sepse kishte shumë mangësi.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetarja tha se sot nuk kërkohet nga anëtarët e Komisionit të miratohet ky plan, por kërkohet që të merret vendim për organizimin e një tryezë pune, së bashku me shoqërinë civile dhe të gjithë ata që janë të interesuar, që të ndihmojnë Komisionin për Integritet Evropian.

Në vazhdim, tha se plani kombëtar për zbatimin e MSA-së, iu është shpërndarë deputetëve, dhe si pikë mjaft e rëndësishme për integritet evropian, ne sot duhet të marrim vendim që ta organizojmë një punëtori dhe ta analizojmë, në mënyrë që ta bëjmë sa më mirë zbatimin e planit kombëtar për MSA-në.

Lidhur me këtë, hapi debat.

Kujtim Paqaku, kërkoi që të futet kërkesa e bërë edhe më herët për iniciativën për krijimin e rrjetit të deputetëve romë, në kuadër të Evropës, me qëllim që të rritet bashkëpunimi me institucionet evropiane në Kosovë dhe me institucionet evropiane në Evropë, për shkak se dëshirojmë t'i evitojmë dhe identifikojmë problemet e romëve dhe diskriminimet që bëhen në punësim, në regjistrim të studentëve në universitetet tona, uzurpime të pronave. Ky mekanizëm do të jetë edhe lobues për të ardhmen, për çështjen e Kosovës.

Në fund, pas diskutimeve të anëtarëve nga ky takim, u nxorën këto përfundime:

1. Raporti nga vizita në Bruksel, t'i përfshijë edhe diskutimet që janë bërë gjatë takimeve të ndryshme dhe t'u shpërndahet anëtarëve në mënyrë elektronike.
2. U vendos që të formohen grupe të deputetëve të Komisionit për Integritet Evropian, për të realizuar disa vizita në shtetet e BE-së, si dhe të kërkohet nga Kryesia lejimi i tyre.
3. Të organizohet një tryezë pune, së bashku me shoqërinë civile, lidhur me planin e punës së Komisionit për vitin 2016.
4. Të organizohet edhe një punëtori njëditorë për planin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim - Asociim.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë, **Xhavit Haliti** kërkoi që të trajtohet çështja e shoqërisë civile, pasi që ngriti dyshime se disa prej tyre flasin si të jenë shoqëri e instrumentalizuar.

Ai tha se nuk e di kush është shoqëria civile në Kosovë, sepse ne kemi të ashtuquajturat, shoqëri civile, që paguhet prej dikujt dhe kemi shoqëri civile që merren me çështje të caktuara, edhe shoqëri civile, që përbëhet nga mijëra OJQ. Do të duhej të ndërtonin një sistem të vetin, për të ditur kush janë. Më pas, një institucion koordinues dhe jo dy-tre veta, që flasin në vazhdimësi në emër të shoqërisë civile. Unë nuk besoj që e përfaqësojnë shoqërinë civile të Kosovës. Të bisedohet e trajtohet kjo çështje, sepse po më duket që po bisedojmë nganjëherë, jo si shoqëri civile, por si shoqëri e instrumentalizuar.

Ilir Deda, tha se në këtë mënyrë po sulmohet shoqëria civile dhe nuk mund t'i sulmojmë njerëzit që kanë marrë qëndrim politik. Pjesëtarët e shoqërisë civile janë përcaktuar qartë dhe nuk meritojnë sulm.

Xhavit Haliti- Nuk mundet që shoqëria civile të jetë e Kosovës, e të paguhet nga dikush. Nuk po e dënoj shoqërinë civile, është mendim i imi. Ty, në qoftë se të vret, nuk kam çka të bëj, është problem i yti. Ti ke të drejtë të mbrosh shoqërinë civile, nga e cila ke ardhur. Shoqëri civile, nuk mund të jetë e Kosovës, nëse një grup paguhet nga dikush.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Teuta Sahatqija